



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**Këshilli i Ministrave**

**VENDIM**

**Nr. 31 datë 20.1.2001**

**PERFITIMET NGA STATUSI I INVALIDIT PARAPLEGJIK DHE  
TETRAPLEGJIK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenti 21, të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000, "Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Punës dhe Cështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Komisioni mjekësor i caktimit të aftësive për punë (KMCAP), në rreth, shqyron të gjitha kërkesat e paraqitura nga personat e interesuar, që përfitojnë nga ligji nr. 8626, datë 22.6.2000, pavarësisht nga mosha, nga fakti nëse janë ose jo në marrëdhënie pune, nga koha a vendndodhja e absent apo nga casti i sigurimit. Komisioni vendos edhe shkallën e invaliditetit, sipas nëarjes që vijon:

I. Grupi i parë, ku përfshihen:

a) të sëmurët tetraplegjikë, që kanë humbur mbi 55 për qind të aftësisë për punë, që nuk kanë mundësi fizike për të vetëshërbyer e që kanë nevojë për kujdestar.

b) të sëmurët paraplegjikë, që kanë humbur mbi 55 përqind të aftësisë për punë, që nuk kanë mundësi fizike për të vetëshërbyer e që kanë nevojë për kujdestar.

II. Grupi i dytë, ku përfshihen të sëmurët paraplegjikë, pjesërisht të afte për punë të përzgjedhur, që janë në gj endje për të vetëshërbyer.

2 .KMCAP-ja i lëshon të interesuarit raportin mjekësor, duke përcaktuar shkallën e paaftësisë dhe nevojën për kujdestar. Invalidi, paraplegjik ose tetraplegjik, duhet të deklarojë para administratorit shtetëror emrin e kujdestarit i cili shënohet në një regjistër të vecantë. nëërrimi i kujdestarit mund të bëhet sa herë që invalidi, paraplegjik ose tetraplegjik, e sheh të arsyeshme, por është i detyruar të njoftojë menjëherë KMCAP-në.

3. Invalidët, paraplegjikë ose tetraplegjikë, pajisen me dëshmi zyrtare identifikimi.
4. Masa e pagesës për invalidët, paraplegjikë ose tetraplegjikë, dshtë 70 për qind e pagës minimale të punonjësit buxhetor dhe nëryshon sa herë nëryshon kjo pagë. Pagesa përfitohet pavarësisht nga moshja dhe të ardhurat e tjera, që invalidi, paraplegjik ose tetraplegjik, përfiton nga shteti. Të njëjtën pagesë përfiton edhe kujdestari i invalidit paraplegjik ose tetraplegjik, i caktuar në përputhje me pikën 1 të këtij vendimi.

Vendi dhe mënyra e dhënies së këtyre pagesave do të përcaktohet në udhëzimin, që do të dalë në zbatim të këtij vendimi.

5. Efektet financiare për këto pagesa të përballohen brenda fondeve të dhëna për vitin 2001, Administratës së Përgjithshme të nëihmës dhe Shërbimeve Sociale,' në zërin "Përfitim paaftësie".

6. Personat që do të fitojnë statusin e invalidit paraplegjik ose tetraplegjik, para datës 30 qershor 2001, do ta përfitojnë këtë pagesë, në zbatim të pikës 4 të këtij vendimi, që nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000, "Statusi i invalidit paraplegjik ose tetraplegjik" Të gjithë personat e tjerë që do ta fitojnë këtë status pas datës 30 qershor 2001, do ta përfitojnë këtë pagesë një muaj pas daljes në KMCAP.

7. Për cdo shpërdorim, personit përgjegjës i merret dëshmia për një periudhë deri në 3 vjet dhe, sipas rastit, zbatohen edhe dispozitat për kundërvajtjet administrative deri në kallëzim për nëjekje penale.

8. Ngarkohen Ministria e Punës dhe Cështjeve Sociale dhe Ministria e Financave të nxjerrin udhëzimet përkatëse, në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

**KRYEMINISTRI  
ILIR META**